

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Fejzullah Rexhepi dhe Albert Zogaj, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.R.i nga Prishtina, kundër të paditurës Posta dhe Telekomit i Kosovës në Prishtinë, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas ankesës të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1023/2012, i dt.27.08.2014, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 12.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PJESËRISHT APROVOHET ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomit i Kosovës në Prishtinë dhe **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr. 1023/2012, i dt.27.08.2014 në pjesën detyruese me të cilën është detyruar e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 6 për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012, e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të cilën paditësi të e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, me kamatë prej 4% duke filluar nga data 01.12.2012 e gjer në pagesën e plotë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit dhe lënda në këtë pjesë, si dhe për shpenzimet e procedurës i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

II.REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomit i Kosovës në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1023/2012, i datës 27.08.2014, në pjesën me të cilën është aprovuar kërkesëpapia e paditësit N.R.i nga Prishtina dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01-1040-602/2012 i datës 07.03.2012.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit dhe në pikën I të dispozitivit është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01-1040-602/2012 i datës 07.03.2012 dhe është detyruar e paditura që paditësit ti paguaj ndryshimin e pagës, ndryshimin e bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 6 për çdo muaj duke filluar nga data 01.02.2012 e në muajt në vazhdim sipas kontratës së punës me të

cilën paditësi të e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar me kamatë prej 4%, duke filluar nga data 01.02.2012 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta hedhë padinë e paditësit si të pasafatshme, ose ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që ta refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ose ta prishë aktgjykimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi N.R.i nga Prishtina ka ushtruar padi kundër të paditurës Posta dhe Telekom i Kosovës në Prishtinë për kompensimin e diferencës së pagës, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadiës si dhe i kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se vendimi mbi uljen e gradave është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me autorizimet dhe kompetencat e punëdhënësit si dhe me vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës për reduktimin e shpenzimeve për personelin e të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në kontratën e punës e lidhur në mes të punëdhënësit – të paditurës dhe punëmarrësit – paditësit të datës 20.10.2011, në bazë të së cilës paditësit i është caktuar grada 7 si pagë bazë për punën e kryer, po ashtu aktgjykimin e ka bazuar edhe në dispozitat e nenit 11,55 dhe 87 të Ligjit të Punës si dhe dispozitave të nenit 186 dhe 277 të LMD-së.

Në këtë gjendje të vërtetuar, përfundim të tillë të gjykatës së shkallës së parë kjo gjykatë nuk mund ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm sa i përket pjesës detyruese lidhur me detyrimin e të paditurës që paditësit të paguaj ndryshimin e

pagës, bonusit dhe trustit në mes të gradës 7 dhe 6, me të dhëna të tjera si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, pasi që kemi të bëjmë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 n) të LPK-së, pasi që vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar dhe arsyetimi i tij është kundërthënës në mes veti. Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në pjesën detyruese nuk ka përcaktuar vlerën monetare – dallimin në mes të gradës 7 dhe 6 që duhet ti paguaj e paditura paditësit, ndonëse paditësi në padinë e parashtruar në kërkesëpadi ka caktuar shumat mujore si kërkesë e tij për pagesë, e mos caktimi i shumave me të cilat detyrohet e paditura për pagesën e dallimit në mes të gradës 7 dhe 6, aktgjykimin e bënë të paqartë dhe si të fillë të papërshtatshëm edhe për ekzekutim, pra dispozitivi i aktgjykimit me të cilin vendoset për kërkesën për pagesën e të ardhurave personale duhet të përfshi shumat dhe periudhën për të cilën është aprovuar apo është refuzuar kërkesa.

Gjykata e shkallës së dytë sa i përket vendosjes për kërkesëpadinë e paditësit në pjesën e dispozitivit me të cilën është aprovuar kërkesëpadija e paditësit dhe është anuluar aktvendimi i të paditurës nr.01-1040-602/2012 i datës 07.03.2012, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë pjesë të aktgjykimit dhe nuk është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat është thirrur pala e paditur si dhe në dispozitat e nenit 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, gjithashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e anulimit të aktvendimit të paditurës nr.01-1040-602/2012 i datës 07.03.2012, drejtë e ka zbur ligjin material – dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës në Kosovë.

Gjykata e shkallës së dytë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me të cilin vendim paditësit i është ulur grada e të ardhurave personale nga grada 7 në gradën 6, konsideron se gjykata e shkallës së parë vendimin e sajë për të anuluar aktvendimin mbi caktimin e lartësisë të ardhurave personale, të nxjerrë nga kryeshefi ekzekutiv i të paditurës, është i bazuar dhe ka mbështetje ligjore në dispozitat e nenit 10 par.1 dhe 2 pika 2.1 nenit 11 dhe 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës në Kosovë lidhur me nenin 5 të kontratës së punës të lidhur me datë 20.10.2011. Gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se vendimi i anuluar është në kundërshtim me dispozitat e nenit 55 par.1 të Ligjit të Punës të Kosovës ku parashihet, “i punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit”, dhe në kundërshtim me nenin 5 të Kontratës së Punës ku shprehimisht është paraparë, “se të punësuarit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 7 sipas vendimit të bordit të përkohshëm të drejtuarve të PTK-së, së paku njëherë në muaj, e cila nuk

mund të jetë më e ultë se paga minimale". Po ashtu kjo gjykatë vlerëson se gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë sa i përket vendimit për anulimin e vendimit, duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë dhe se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sa i përket anulimit të aktvendimit mbi caktimin e lartësisë të ardhurave personale të cekur si më lartë, sepse paditësi dhe e paditura raportet e tyre, të drejtat dhe detyrimet e tyre punëdhënës – punëmarrës i kanë rregulluar me kontratë të shkruar duke i përcaktuar saktë të drejtat dhe detyrat e tyre reciproke në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës, se kushtet e kontratës së punës janë përcaktuar në kontratë në mes paditësit dhe të paditurës duke u marrë për bazë edhe lartësia e pagës, përkatësisht të gradës të ardhurave personale sipas të cilës do të paguhet paga e punëtorit për punën e kryer, gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se është parim i të së drejtës që palët me vullnetin e tyre të lirë të shprehur apo me veprimet konkludente mund të krijojnë raporte juridike – marrëdhënie juridike, e gjithashtu palët me vullnetin e tyre të shprehur apo me veprime konkludente mund të ndryshojnë apo të shuajnë një marrëdhënie juridike – raport juridik, pra në rastin konkret kjo gjykatë vlerëson se kontrata e punës e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës ka pasur mundësi të ndryshohet vetëm me vullnetin e shprehur të dyja palëve dhe se e paditura nuk ka pasur mundësi të ndryshoj kushtet e kontratës vetëm me shprehjen e njëanshme të vullnetit të sajë dhe se aktvendimi për ndryshimin e lartësisë së gradës duke e zvogëluar gradën e pagës bazë është i padrejtë dhe në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe me nenin 5 të Kontratës së Punës dhe se një aktvendim i tillë nuk mund të pranohet si pjesë e kontratës së punës, gjersa të dy palët nuk pajtohen për ndryshimin e kushteve të kontratës, e cila është dashur të bëhet me aneks kontratë apo kontratë të re e jo siç ka bërë e paditura me aktvendimin e saj me shprehje të njëanshme të vullnetit. Gjithashtu pretendimi i të paditurës se në bazë të nenit 5 të Kontratës së Punës, aktvendimi për uljen e gradës është i ligjshëm, është i pabazë, pasi që në bazë të këtij neni të kontratës punëdhënësi ka ruajtur të drejtën e caktimit të vlerës së gradës, por jo edhe uljen e gradave, pasi që e njëjta është caktuar me kontratë, pra ka mundur ta ulë vetëm vlerën e koeficientit.

Gjykata e shkallës së dytë sa i përket pretendimit të paditurës se ka qenë e detyruar të veproj në bazë të vendimit të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik të datës 06.12.2011, në bazë të cilit ka konstatuar se kërkesa e aksionarit – Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka qenë ulja e shpenzimeve operative për personelin e të paditurës në raport me të hyrat e përgjithshme të PTK-së për vitin 2012 e cila duhet të jetë jo më shumë se 20%, e cila kërkesë nuk ka qenë kërkesë e uljes së gradës të ardhurave personale dhe si e tillë nuk ka mundur të bëhet në mënyrë të njëanshme, siç e ka bërë e paditura në rastin konkret, për çka

edhe vendimi i kontestuar është i padrejtë dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu kjo gjykatë vlerëson se është i pabazuar edhe pretendimi i të paditurës se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ka nxjerrë në shkelje të nenit 401 të LPK-së pasi që nga procesverbali mbi mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor, vërtetohet se nuk ka pasur vërejtje për mbajtjen e seancës e asë kërkesë nga palët që seanca e shqyrtimit kryesor të shtyhet për ndonjë arsye dhe me këtë nuk ka ndonjë shkelje që do të ndikonte në ligjshmërinë e vendimit të atakuar. Gjykatës të shkallës së parë konform nenit 401 të LPK-së i është lënë mundësia nëse duhet të caktoj seancën përgatitore duke marr për bazë ndërlíkueshmërinë e rastit, andaj është çështje e vlerësimit të gjykatës në të cilën palët kanë mundur të japin vërejtjet e tyre gjatë seancës.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve në procedurë, duhet të vendos në atë mënyrë që dispozitivi të jetë i qartë dhe të përmbajë kërkesën e palës paditëse, duke përfshirë edhe vlerat monetare si dhe periudhën për të cilën është kërkuar pagesa e të ardhurave personale dhe kërkesat tjera.

Nga të cekurat më lartë e konform dispozitave të nenit 195.1 c) dhe d) lidhur me nenin 200 të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4883/2014,më dt. 12.01.2017

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 12.01.2017, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:**Anëtarët e kolegjit****Kryetari i kolegjit**

1. _____

2. _____